



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Mbledhja nr. 71

Prishtinë, më 22.03.2013, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Rexhep Selmi, Goran Marinković, Fatmir Xhelili, Anton Quni, Vjollca Krasniqi, Ganimete Musliu dhe Rasim Demiri.

Mungoi: Danush Ademi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Naim Hoxha-OSBE, Dhurata Kryeziu-OSBE, Visar Rushiti- GAP, Skender Perteshi, QKSS, Venera Gashi, praktikante.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku, Haxhi Xhemajli, Zarife Aliu dhe Antigona Ibraj.

Mbledhjen e kryesoi: Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit të mbajtur më 11.03.2013;
3. Shqyrtimi i informatës së shefit të Misionit të EULEX-it, z. Bernd Borchardt, rreth angazhimeve të këtij misioni për ruajtjen e paqes dhe sundimin e ligjit në Kosovë;

4. **Shqyrtimi dhe miratimi i propozim - amendamenteve për Projektligjin nr. 04/L-177 për Dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit;**
5. **Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e rendit të ditës.

1. Miratimi i Rendit të ditës

Kryetari i Komisionit- E filloi takimin e radhës së Komisionit duke kërkuar nga anëtarët pajtimin e tyre për miratimin e rendit të ditës.

Rendi i ditës u aprovua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes të Komisionit të mbajtur më 11.03.2013

Kryetari i Komisionit- Konstatoi miratimin e procesverbalit të mbledhjes të Komisionit, të mbajtur më **11.03.2013**. Procesverbali u aprovua pa ndryshime.

3. Shqyrtimi i informatës së shefit të Misionit të EULEX-it, z. Bernd Borchardt rreth angazhimeve të këtij misioni për ruajtjen e paqes dhe sundimin e ligjit në Kosovë.

Kryetari i Komisionit- Nga takimi i kaluar është rënë dakord në Komision kërkitimi i informatës nga EULEX-i, për situatën e sigurisë në veri të vendit. Kjo informatë është paraqitur dhe konsideroj se përfshinë të gjitha zhvillimet për situatën e sigurisë në Kosovë, përshkrimin e misionit të EULEX-it në Kosovë, si dhe bashkëpunimin me mekanizmat ndërkombëtarë, siç është bordi i përbashkët i EULEX-it, institucioneve të Republikës së Kosovës, si dhe krijimi i task-forcës në veri të vendit, me qëllim që të jetë aktiv mes EULEX-it dhe mekanizmave, të cilët mund të jenë në veprim për sigurinë e qytetarëve.

Gjithashtu në këtë informatë përfshihen edhe angazhimet e marra pas incidenteve që kanë ndodhur në veri të vendit, për të cilën gjë është kërkuar informatë. Kjo ka të bëjë me shtimin e pranisë më të madhe në këtë pjesë, si dhe masat e ndërmarra për patrullime me të shpeshta me një koordinim më të mirë me institucionet e Kosovës. Po ashtu konsideroj se kjo informatë është një komunikim me institucionet ndërkombëtare që veprojnë në vend.

Rexhep Selimi- Konsideroj se informata e paraqitur nga EULEX-i për Komisionin është e sinqertë, duke iu referuar paragrafit të gjashtë të kësaj informate, në të cilin përshkruhet roli i EULEX-it dhe gjendja në veri të vendit.

Theksoj që kërkitimi i informatës për situatën e sigurisë në veri të vendit është dashur t'u bëhet institucioneve të Republikës së Kosovës, por konsideroj se nga kjo informatë misioni i EULEX-it nuk është për t'u kritikuar. Duke iu referuar paragrafit të gjashtë të

kësaj informate, thuhet se “*EULEX-i është në pritje të një zgjidhje në nivel politik*”, në këtë pikë konsideroj se është një vlerësim real duke lënë të kuptohet se nuk mund të japin më shumë se sa pritjet nga ana e këtij misioni.

Nga informata e paraqitur nga misioni EULEX, çështja në veri mbetet një brengë, e cila në tërësi është për të gjithë qytetarët dhe do duhet të ishte për institucionet e sigurisë së Republikës së Kosovës, prandaj konsideroj se kjo informatë për situatën e sigurisë në vend do duhej të kërkohej nga Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës dhe jo nga EULEX-i.

Anton Quni- Duke iu referuar informatës së misionit EULEX-it drejtuar Komisionit, në paragrafin e gjashtë të tij thuhet: “*Kontributi në sundimin e ligjit në pjesën veriore të Kosovës është një prej prioriteteve të Misionit, në pritje të një zgjidhje në nivel politik*”. Veprimtari të tilla si, krimi i organizuar, shpëlarje parash, trafikimi me narkotik dhe qenie njerëzore, kufizimi i lëvizjes së lirë, luftohen në mënyrë të vazhdueshme pa kompromis, në të gjitha rrethanat e zhvillimeve politike. Për ndryshe strukturat kriminale legjitimohen për të përcaktuar zhvillimet politike, dhe kjo nuk është praktikë e shteteve demokratike.

Nga misioni EULEX, presim që të veprojë sipas mandatit, pasi ka autorizimet dhe kuadrot, teknikën, fondet dhe të gjitha mundësitë për bashkëpunim me institucionet vendore.

Vjollca Krasniqi- Në mbledhjen e kaluar nga Komisioni është shqyrtuar raporti i Ministrisë së Punëve të Brendshme për situatën e sigurisë në vend, i cili është vlerësuar nga anëtarët si përshkruar dhe informues aq sa mund të informohemi nga mediat. Gjithashtu u vlerësua se Ministri i MPB-së, nuk ka pushtetin për të ndërhyrë në pjesën veriore të vendit, përderisa një pushtet i tillë nuk i mungon në pjesën tjetër, siç ishte rasti gjatë protestave të 22 tetorit 2012, të zhvilluara në Prishtinë, ose deklaratimet e ministrit në Kuvend se nuk do të ketë tolerime për të gjithë ata që shkelin ligjin.

Në informatën e paraqitur nga EULEX-i, vërehet e njëjta gjë, është një përshkrim i misionit dhe objektivave të tij, ose çështjes se për zgjidhjen e situatës në veri janë në pritje të një zgjidhje politike.

Nga misioni EULEX, pritjet qytetare kanë qenë më të mëdha, sidomos për çështjen e zbardhjes së krimeve që kanë ndodhur pas vitit 1999, siç kanë qenë vrasjet politike, atentati ndaj Presidentin Ibrahim Rugova, vrasja e figurave të shquara të Lidhjes Demokratike të Kosovës, prandaj konsideroj se misioni EULEX-it nuk ka bërë angazhimin e duhur për zbardhjen e këtyre rasteve.

Konsideroj se misioni EULEX-it do duhej të punonte në drejtimin e zbardhjes së rasteve, pasi drejtësia në Kosovë druajmë se nuk do ta bëjë një gjë të tillë. Prandaj konsiderojmë se misioni i EULEX-it do duhej të ishte më këmbëngulës për zbardhjen e këtyre rasteve.

Ganimete Musliu- Paraqitjen e këtij informacioni nga ana e EULEX-it në Komision e vlerësoi si pozitive, raport i cili tregon për gatishmërinë e tyre për të bashkëpunuar me Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së.

Një raport i tillë bashkëpunimi do t'i shërbejë punës së Komisionit, që në të ardhëm të jemi më kërkues për bashkëpunimin e mekanizmave të sigurisë në Kosovë për koordinimin e aktiviteteve. Për këtë arsye këtë informatë e vlerësoj si pozitive dhe një standard i mirë për vendosjen e komunikimit mes institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, duke shpresuar për bashkëpunim të vazhdueshëm.

Fatmir Xhelili- Falënderoj misionin e EULEX-it për përgjegjësinë dhe për përgjigjeje ndaj Komisionit. Paraqitjen e këtij raporti e konsideroj si nismë e një relacioni pozitiv, prandaj përkrah punën e mëtutjeshme të tyre.

Kryetari i Komisionit- Konstatojmë se një informatë e tillë nga misioni i EULEX-it i është dashur Komisionit dhe përgjigjja ndaj kërkesës sonë është hap i mirë për bashkëpunimit, në mënyrë që në periudha, kur mund të kemi veprime që rrezikojnë sigurinë në vend, të ketë komunikim mes institucioneve të sigurisë.

Gjithashtu edhe më tutje kërkojmë angazhimin e misionit EULEX, si mision i cili është i angazhuar për ndihmë të institucioneve të Kosovës për rend dhe ligj, në mënyrë që pas përfundimit të këtij misioni të mbetet imazh pozitiv i tyre, pasi bashkë me bashkësinë ndërkombëtare qëllimi është që të kemi sukses si institucione vendore.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim - amendamenteve për Projektligjin nr. 04/L-177 për Dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit.

Kryetari i Komisionit- Për këtë projektligjin për dërgimin e FSK-së jashtë vendit, është bërë amendamenti i tij dhe se në të është bërë një punë e mirë. Fjalën ia kaloi z. Anton Quni, kryesues i grupit punues.

Anton Quni- Njoftoi se anëtarët e grupit punues për projektligjin për dërgimin e FSK-së jashtë vendit, në vazhdimësi kanë pasur kontakte me autoritetet e Ministrisë së FSK-së. Për nenet të cilat kanë qenë diskutabile janë diskutuar dhe jemi pajtuar për të bërë ndryshimet duke shpresuar që projektligji të jetë funksional. Prandaj propozoi që amendamentet e propozuara të marrin miratimin e Komisionit për t'u proceduar më tutje në Kuvend.

Fatmir Xhelili- Pajtohem me propozimet e bëra për projektligjin për dërgimin e FSK-së jashtë vendit, ndryshimet që janë bërë kanë qenë më shumë të natyrës teknike. Prandaj propozoj që amendamentet e propozuara të përkrahën dhe se ligji i nxjerr do të lehtësonte punën e FSK-së.

Kryetari i Komisionit- Meqë amendamentet e ofruara janë të pranueshme do të jenë të gatshme të procedohen në seancë për votim.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, me vota unanime, nxori këtë

PËRFUNDIM

Miratohen propozim-amendamentet për Projektligjin nr. 04/L-177 për dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit.

5. Të ndryshme.

Kryetari i Komisionit- Propozoi që në takimin e radhës së Komisionit të ftohet ministri i FSK-së, z. Agim Çeku, për raportim të rregullt në Komision për punën dhe planet e tyre për vitin 2013. Gjithashtu edhe vizitat të cilat janë të parapara në planin e punës do të realizohen, tutje njoftoi anëtarët e Komisionit për vizitën që do të realizoj në Bruksel, në selinë e NATO-s.

Rasim Demiri- Njoftoi Komisionin lidhur me arrestimin e z. Nazmi Mustafi, kryeshef i task forcës kundër korrupsionit. Më 15.03.2013, në orën 21:00, forcat speciale të policisë së Kosovës, në mënyrë brutale, në prezencë të familjes kanë keqtrajtuar të arrestuarin, gjithashtu kemi dëshmi se vajza e tij është dashur të dërgohet në spital. Nuk e kuptoj pse është bërë një gjë e tillë, pasi z. Mustafi ka qenë i liruar me kaucion dhe është bërë pagesa prej 10.000 euro, si dhe më vonë 15.000 euro janë deponuar dhe se ai nuk ka pasur qëllim ikjen, por ka pritur vendimin e drejtësisë. Shqetësuese është mënyra e sjelljes ndaj tij dhe për këtë gjë do të ankojemi edhe në Ministrinë e Punëve të Brendshme, EULEX-i, pasi kjo mënyrë e sjelljes ndaj tij nuk është në rregull.

Kryetari i Komisionit- Në këto raste janë dy elemente, në rast se ka tejkalim të kompetencave nga ana e policisë, është obligim i familjarëve për ta lajmëruar një rast të tillë, ndërsa elementi i dytë, nëse Komisioni do të kërkon të informatë, një gjë e tillë do të duhej të kërkohej kryeshefit të IPK-së, pasi paraqitjes së rastit në këtë institucion.

Fatmir Xhelili- Për rastin e paraqitur nga z. Demiri, konsideroj se në rastet kur njësia speciale vepron, kjo gjë bëhet sipas procedurave që i obligon përshkrimi i detyrave të punës. Në rastet kur mund të ketë tejkalim të përdorimit të forcës nga ana e policisë gjatë arrestimeve, ankesat duhet paraqitur në IPK, si institucion kompetent për trajtimin e rasteve, ndërsa në rastin kur ky institucion nuk ndërmerri masa pas paraqitjes së rastit, në këtë rast është Komisioni që duhet të mbikëqyrë punën e tyre.

Rexhep Selimi- Për rastin e paraqitur nga z. Demiri, konsideroj se nuk duhet të merremi shumë me mënyrën e reagimit të njësisë speciale, por do të duhej të diskutohej urdhëresa për arrest ndaj z. Mustafi, sesa të fajësohen forcat speciale, të cilat në këtë rast kanë zbatuar urdhrin.

Kryetari i Komisionit- Konsideroi se veprimi që është bërë në këtë rast, nëse personi i dëmtuar do të bënte ankesë tek institucionet adekuate, në rast se nga ana e tyre nuk ndërmerren hapa në këtë rast, Komisioni do të reagojë për, pa ndërmarrjen e hapave të tillë nuk do të mund të diskutoheshin raste të tilla në Komision.

Me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroi mbledhjen të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ahmet Isufi